

KOMUNA E KLINËS
DREJTORIA PËR GJEODEZI, KADASTËR DHE PRONËSI
Nr. 11-729
KLINË, 28.2.2019

NJOFTIM PËR QYTETARËT E KOMUNËS SË KLINËS

Emërtimet e rrugëve dhe shesheve të Komunës së Klinës, janë bërë me Vendimin e Kuvendit të Komunës së Klinës, në seancën e VII-të të Kuvendit, të datës, 20.7.2015. Prandaj, ekzekutimin e këtij Vendimi e bën Drejtoria e Kadastrit, Gjeodezisë dhe Pronësisë, në bashkëpunim me Agjencionin Kadastral të Republikës së Kosovës.

Komuna e Klinës për implementimin e këtij projekti ka siguruar një donacion nga Qeveria Norvegjeze dhe ky projekt në të gjitha vendbanimet e Komunës së Klinës është duke u implementuar dhe tash gjendet në fazën përfundimtare të vendosjes së tabelave.

Komuna e Klinës, përkatësisht Kuvendi i Komunës, në seancën e IX-të të Kuvendit të Komunës, të datës 26.10.2018, me Vendimin, 01Nr.06.7295/2018, ka themeluar një Komision për shqyrtimin e ankesave për emërtimin e rrugëve, shesheve dhe vendbanimeve në territorin e Komunës së Klinës.

Sipas Vendimit, Komisioni është obligativ që të angazhohet në shqyrtimin e ankesave për emërtimin e rrugëve posa të përfundojnë procedurat e sistemit të adresave sipas vendimit të fundit të Kuvendit të Komunës, për emërtimin e rrugëve, Nr. 01 Nr.06-4427/2015, i miratuar më 20.7.2015.

Njoftojmë qytetarët e Komunës së Klinës se të drejtë ankese kanë deri më datën 14.03.2019.

Po ashtu, njoftohen qytetarët që dëmtimi i çdo table është veprë penale dhe dënohet me ligj.

Më respekt.

Drejtoresha për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronësi,

Njomza Grabanica



